



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:007563
Datë: 21.10.2024
Numri i dokumentit: 06324288

C-IV-14-6870

Parashtruesi i kërkesës

H I nga Vitia.

kundër

Pala kundërshtare

Agjencioni Kosovar i Privatizimit- AKP (NSH - NBI “Agromorava” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 21 tetor 2024 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 31 tetor 2014, pranë DHPGJS, ankuesi parashtroj një kërkesë për rishikimin e Vendimit (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) GJI035-0278 datë 8 tetor 2014, lëshuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit të AKP (në tekstin e mëtutjeshëm AL) me anë të cilit, është refuzuar kërkesa e ankuesit mbi kompensimin e pagave të papaguara, për periudhën nga viti 1992 gjer 1999, në shumë të paspecifikuar, ndaj NSH – NBI “Agromorava” (në likuidim).

Ankuesi me anë të kërkesës për rishikim kërkoj kompensimin në shumë prej 19,200.00 (një nëntë dy zero zero) Euro.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e padisë për Gjykatën Komunale në Viti, e dorëzuar me 6 dhjetor 2006,

- Kopja e procesverbalit nga seanca gjyqësore, e mbajtur pranë Gjykatës Komunale në Viti me 19 shkurt 2007,
- Kopja e shkresës – njoftimit të Agjencisë, drejtuar ankuesit, mbi iniciimin e procedurës së likuidimit të NSH, dhe
- Kopjet e Aktvendimeve të Gjykatës Komunale në Viti, datë 26 dhe 28 tetor 2011.

Me 11 korrik 2024, gjykata lëshoj një vërejtje për ankuesin mbi pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje ankuesi u informua se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Vërejtja e lartë cekur, i është dorëzuar ankuesit me 16 korrik 2014.

Gjer me datën e lëshimit të këtij vendimi ankuesi nuk ka paguar taksat gjyqësore.

Arsyetimi ligjor

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Ankuesi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së *ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.*

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh: *Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 11 korrik 2024, gjykata përmes vërejtjes kërkoi nga ankuesi që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Gjykata nga gjitha arsyet e lartë cekura nuk hyri në shqyrtim të çështjes, në merita të saj.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar